



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranimi - Përmirësimi Nr. Data 08-08-2024			
Nr. Komand Orig. Bro.	Titulli	Kategoria Përfaq.	Vlera Vrednost
01-	060/01-	1042	



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të Nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor 2008), dhe të Nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011; Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e VIII të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë: **16.08.2024, (e Premte) në ora 10:00.**

Mbledhja do të mbahet në zyrën e konferencave të objektit të vjetër të Komunës së Vitisë.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Informatë për aktivitetet dhe kontratat e realizuara të prokurimit në periudhën 6-mujore për vitin 2024.

Viti, më 08.08.2024

Me respekt!
Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E SHTATË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **22.07.2024 (e hënë)** në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Illir Zuka, z.Ramadan Deliu, z.Jakup Demiri, znj.Majlinda Shabani, znj.Zejnepe Osmani, ndërsa mungoi znj.Zyrafete Rama. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se ka anëtarë për kourum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Përshëndetje për nënkryetarin e komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, drejtorët që janë prezent në këtë mbledhje. Mirë se keni ardhur në mbledhjen e shtatë të rregullt të KPF-së për këtë vit! Gjatë kësaj periudhe mesa e di nuk na ka ardhë asnjë konfirmim prej seancës së kalume. Para se të hy në rend të ditës hapi diskutimin nëse ka ndonjë pyetje.

z.Illir Zuka: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë e kam bërë para disa seancave një kërkese për shenjzimin e vijave në Pozheran, sidomos këto ditë që kanë ardh mërgimtarët dhe ju uroj pushim të këndëshëm, por në Pozheran tash është bërë e pakalushme, sidomos për gjeneratat e reja. Edhe në mbramje po vazhdon ajo traditë me dalë me hecë gratë, me kolica me fëmijë. Unë kam thanë gjithëhere, ishalla nuk ndodhë ndonjë aksident. Edhe nëpër lagje mungon trotuari, po dalin edhe rrugës kryesore po bëjnë vozitje shumë të keqe. Në qoftë se ka ndonjë mundësi që këto ditë të bëhen ato vija për këmbësor se shumë problem. Edhe një për drejtoreshën e arsimit: A ka ndonjë informatë për shkollën e Pozheranit, a pritet me u bë fillimi në shtator?

z.Arta Ajeti, drejtoreshë: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Sa i përket punës së shkollës në Pozheran, zyrtarisht nuk jam e informuar asgjë, mirëpo sipas disa infomratave që kam kontakti me operatorin ekonomik, pritet që këtë javë vetem të nënshkruhet marrëveshja dhe të vazhdohen punimet. Nuk e di arsyen pse kanë vonu kaq shumë kur është i vetmi operator, kështu që shkresa po bëhet thujse çdo javë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Edhe për atë që kur e ke pyet nënoperatorin të ka thënë që me 1 shtator ki me hy në shkollë, kështu të ka thanë.

z.Illir Zuka: Unë kam kërku edhe në seancen e kalume, mirëpo, pasi nuk ka qenë Jakupi nuk kam dashtë me bë debat. D.m.th, aty ka përfitu tenderin gjoja se kompania më e lirë, që ka qenë dallaver shihet aty. Në momentin kur e ka marrë tenderin e ka nënshkru ekspertiza e shkollës, është bërë me atë ekspertizë të shkollës, është ritenderu shkolla e Pozheranit. Në momentin që e ka marrë atë ka bë kërkesë që nuk është kanë në rregull ajo që me u rritë një shumë begi e madhe e tenderit, e tash kan hi procedurat për me ja vazhdu atë shumë që me i vazhdu punimet.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Pjesa e parë qëndorn aty, kur e ka marrë operatori ka ardhë në objekt dhe gjendja që është tenderu nuk ka qenë në përpruthje gjendja faktike me atë në leter, dhe ai ka kërku një komision dhe komisioni kur ka dalë prej ekspertëve ka konstatu se ai e ka pas të qëlluar për shkak të një prej tyre që mbaj mend kapriatat që jan kanë i ka kap dryshku dhe nuk u përputh me atë tenderin. Ashtu mua më kanë

thanë. Tash po flas që kam kontakt me inxhinerin, dhe ka thanë që, plotësisht kërkesa e operatorit është me vend dhe tash e kanë shqyrtu dhe pritet me u nënshkru kontrata.

z.Jakup Demiri: Ne kemi qenë të dielen e kalume në këshill të përgjishem dhe kemi pasë 3 ministra për raportim, po shkollen e pozheranit kemi diskutu aty na kanë thanë disa prej punimeve që jan kry më heret duhet me u kry serish dhe kompania ka kërku buxhet shtesë diku nja 350 mijë euro ashtu ish i rivlersum dhe pritet me fillu punimet.

z.Illir Zuka: 980 mijë ka qenë kerkesa e parë që e ka bë vlerësimin që pritet me u kry shkolla. Ata kanë hy me 700 e diçka mijë prapë ajo shumë është.

z.Jakup Demiri: Jo nuk është ashtu.

znj.Majlinda Shabani: Ne edhe si grup i opozitës që jemi e kemi adresu atje në Prishtinë gjithë kohes dhe ka pas deputet që janë marrë vazhdimisht me këtë punë, por ne e dimë që janë disa procese ligjore që ne nuk mundemi me i tejkalu dhe qysh prej fillimit që është nisë shkolla është nisë prapë dhe krejt punët kanë shku prap. Ne e dimë që edhe kur ka pas buxhet ndoshta nuk është punu, është ngecë për shkak që ka kalu në OSHP. D.m.th këto procese kanë qenë prej fillimit. Ajo çka tash ne kemi informacionin është kjo që është dashtë me u bë një aneks kontratë me u shtu vlera+300 mijë që tash pritet në bazë edhe prej këshilltares që është në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që kam diskutu bashk me Mirlinden. Ajo thotë që plani dinamik brenda kësaj aneks kontrates me u përfshi këto mjete është plani dinamik për 2 muaj. Tash na duhet me u pa a ka me u kry puna për 2 muaj. Një herë për një here situata është kështu, informacionet qëto janë çka i kemi edhe ne normalisht edhe ne jemi për me u kry shkolla, as nuk jemi për me bë politik, por realisht kaniher diskutimi po bahet kaq i tepërt sa që ne nuk po mundemi me pru një efekt të saj.

z.Illir Zuka: Për juve është i tepërt, por për neve në Pozheran nuk është i tepert. Unë jam taku e dinë Jakupi, bash nuk kam kqyrë politikë hiq. A i kam pritë deputet, i kam pritë krejt, prej 2016 krejt kanë pas faj, por më së shumti ka faj 4-vjeçari i fundit.

z.Jakup Demiri: I vetmi person je kanë që ta kam dhanë informaten kush është tu i blloku punët dhe me ndihmë iki të vetit prap dhe ka dhanë pare landa veq me u vonu, dhe të kam thanë mirrnu si fshat me filanin.

znj.Majlinda Shabani: Pasi qenka nënkryetari këtu, për punimet në shesh qysh jan tu shku dhe kur pritet me u përfundu, se mërgimtarët janë ardh edhe shkun, kështu që çka o ka ndodh, se kam parë ditë që edhe nuk kanë punu hiq, nuk e di si është tu shku puna e punimeve.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Çështja e shenjezimit që e ngriti kshilltari. Unë këtë çështje pas çdo takimi të gjitha pyetjet që i bëni unë i thirri drejtorat, por tani jemi keq se kemi bërë një drejtor atje po na ka ra prej sistemit, për shkak gjendjes familjare që e ka shumë të rendume. Tash nuk e di se sa ofrojnë kushtet dhe operatori ekonomik me i vendos ato shenja. Presion të vazhdueshem jemi tu i bë këshilltare për përfundimin e punimeve te dy anët, edhe pjesën ka lumi "Moravë" dhe këtë pjesën këtu, megjithatë nuk është mbrojtje, por ndikoj tash edhe vendimi i qeveris tash ato të pa përgjegjshimit po e quajmë në këtë formë për shkak të temperaturave shumë të larta, që me të verete ka qenë problematik dhe me punu, megjithatë kam parë që e kanë shtu një intenzitet këtë pjesën këtë, në atë pjesë nuk kam shku me i vizitu, veç i kam parë që tu punu janë, dhe tash për datë e afat kur do të përfodon, unë besoj që përpjekjet janë sa më shpejt. Unë e di që ndoshta pak i kemi pengu bashkatdhetarët, por besoj se edhe ata punën e mirëpresin, se ata janë të tillë, kontribues të vendit dhe kur e shohin vendit që po punohet, por nuk kam parë shumë ankesa në atë drejtim. Një fatë i mirë që Vitia po kalon këto ditë mirë krahasuar nga komuna tjera dhe uroj që të mbyllet sezoni pa probleme, pa telashe të theksume, për shkak se shtimi i popullatës ndoshta nganjehere edhe shfrenimi i ndjenjave te gjeneratat e reja na sjellin gjithhere problem dhe pa fillu mirë, por besoj që do të përfundoj mirë. Uroj që në gjithë Kosovën, por përgjegjës jemi për Viti. Uroj që edhe ju ta jepni kontributin e juaj në formën më të mirë të mundshme t'i presim dhe t'i përcjellim.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit për kontributin! Materialin e keni marrë me kohë. Për këtë seancë kemi parapa këtë.

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Pasqyrat financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-qershor 2024.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2025.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik draft rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2025.
5. Informatë nga DKA-ja, zhvillimi i procesit edukativo-arsimor dhe përfundimi i gjysmëvjetorit të dytë për vitin shkollor 2023-2024.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Te materiali që keni marrë ju mungon rregullorja për taksa ngarkesa dhe gjoba, vetëm ka ardh si propozim vendim për diskutim publik. Parimisht na pa materil nuk mundemi me kalu në kuvend. Tash nëse e qojmë për kuvend si diskutim publik si pikë e rendit ditës tani me ardh. Nëse deri atëhere është çështje tjetër, përndryshe nëse nuk vjen edhe pse ka me dalë në diskutim nuk është në miratim, por pa qenë materiali i gatshëm ne nuk mundemi me qitë në disutim pulbik. Nëse ka dikush te rendi ditës urdheroni. Pasi që nuk ka për debat e qesë në votim. Pra, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, me të gjitha votata pro miratohet rendi i ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e Komitetit për Politikë dhe Financa

z.Illir Zuka: Këtu kur e kam diskutu e kanë shkru, shkak janë bërë nxënësit që janë fshij vijat e këmbësorëve aty që e kam bërë kerkesën. Aty nuk jan shkak nxënësats që janë fshi po nuk e di pse e kanë shkru.

z.Jakup Demiri: Faqe 4, ku e kam fjalën unë shkruan, Ligji i Pagave është kur ka qenë atëhere me 105, tash kalon automatikisht veq me nënshkrim të ministrit bëhet 110 euro, ajo veç është e votume. Ka rritje në vlerën e koeficientit ka rritje 5 euro jo 5%, po 5 euro.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Me këto përmirësime a jeni që të miratohet procesverbali? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet procesverbali.

Si pikë e dytë të rendi të dites kemi:

2. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-qershor 2024

znj.Milihate Ajeti, drejtoreshë: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Buxheti Komunal për vitin 2024 ka marrë aprovimin nga kuvendi komunal, prandaj jemi të obliguar që në periudhen 3 mujore të raportojmë para kuvendit për zbatimin e planit buxhetor të aprovuar. Për këtë periudh 6-mujore kemi në dispozicion buxhtin e alukuar në vlerë prej 12 milion e 850 mijë e 69.21 euro. Janë shpenzuar deri më tani 11 milion e 661 mijë e 824.46 apo edhe shprehur në përqindje 91%. Buxheti i shpenzuar për këtë periudhë gjashtëmujore në krahasim me buxhtin vjetor të aprovuar është 67.71% sipas kategorive ekonomike. Pagat janë shpenzuar 99.53%, mallrat dhe sherbimet 87.78%, komunalit 91.42%, subvencione dhe transfere 81.01%, investimet kapitale 73.01%, këtë gjashtëmujorë shënon një rritje të shkallës së ekzekutivit të pagesave, veçanarisht tek investimet kapitale në krahasim me periudhat paraprake, por gjithashtu shënon një rritje e një dinamikë më të përshpejtuar të ekzekutimit të punimeve në teren, ku ne si Drejtori e Financave kemi qenë në proces të përcjelles së dinamikës së ekzekutimit të punimeve dhe sipas kekresave të menaxherave të projekteve kemi bërë një kërkesë për alokimet e parakohëshme të mjeteve buxhetore të investimeve kapitale, prandaj një shkallë të realizimit bazuar në planifikim vjetor 56.32%. Krahasim me vitin e kaluar shpenzimet në këtë 6-mujorsh janë më të larta për 5 milion e 97 mijë e 637.08 euro apo edhe në përqindje 77.65% janë më të larta. Të hyrat e planifikuara për periudhën 6-mujore kanë qenë 540 mijë e 751 euro. Të hyrat e realizuara për këtë 6-mujorsh janë 480 mijë e 306.73 euro apo shkalla e realizimit bazuar në planifikimin e 6-mujorshit është 93.315, ndërsa bazuar në planifikim vjetor shkalla e realizimit është 46.65%. Të hyrat vetanake në këtë 6-mujorsh janë më të ulta krahasuar me të njëjten periudhë të vitit të

kaluar, për arsyen siç jeni të njotuar në vendimin e nivelit qendror janë hequr kushtëzimet e pagesës së tatimit në pronë. Invesimet kapitale për këtë periudhë 6-mujore, të cilat janë me vlerë 2 milion e 222 mijë e 735.73 euro, janë financuar nga këto fonde burimore: grandit qeveritar është 80.36%, të hyrat vetanake 13.04% dhe donacionet participimet janë 6.60%. Kaq kisha në pika të shkurta. Materialin e keni marrë me kohë, për çdo pyetje shtesë jam në dispozicionin tuaj.

z.Jakup Demiri: Drejtoreshë, 11211 provoja e punës 180 mijë euro nuk po e kuptoj boll. Edhe 13509 dhe pajisjet tjera. Praktikën e mëhershme të pasqyrat financiare me ditë çka janë, se shumë është 226 mijë. Dhe 14032, mirëmbajtja e rrugeve lokale 166 mijë e 538 euro. Nuk e di se sa janë mbajtur rrugët për këtë 6-mujorshin. A është kjo edhe për pjesën e dimrit? Mandej 1422, i ki mirëmbajtja e ndërtesave, këtu është 160 mijë euro. Shtesa e veçantë për të zgjedhurit është 15 mijë e 407 euro 11430. Te shërbimet e ndryshme shëndetësore i ki 13430, është 233 mijë e 831 euro. Shuma a është kjo me kontratën me Karitasin? Kam edhe pyetje tjera, por për kuvend.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Shtesa e veçantë është edhe te kuvendi. Tash i kanë ndryshu përshkrimet. Këto janë me siguri këto komitetet çka paguhen.

z.Illir Zuka: Paraprakisht diskutove edhe me drejtoreshen. D.m.th të hyrat vetanake dihet për çka është numri më i vogël, për shkak që vitin e kaluar kemi votu vendimin për faljen e 50%. Është dhe një gabim teknik i drejtoreshës dhe atë e diskutum tek grandet që e ka qitë 00. Po besoj që nuk është, po tash na jep një arsye, për shkak që gabimisht e kanë qitë 00. Ne dimë që sa puna është bërë që me ato punë besoj që kanë dhanë dhe parë.

znj.Majlinda Shabani: Te krahasimet. Unë te bujqësia e kam një kodë buxhetor, është 13445, shërbimet e veçanta, konsulent dhe kontraktor individual, e ka vlerën 5606, informacion shtesë, për çka janë kanë ato shërbime të veçanta? Konsulent, për çka janë përfshi, dhe gjithsej kur i kemi të gjitha njësitë buxhetore me kod buxhetor 13445? D.m.th, i ke edhe këtu, prapë është bërë shërbimet konsulente. Po është në përgjithësi edhe këto për çka janë. Tjetra, në shëndetësi është furnizime mjekësore me kod buxhetor 13630, me vlerë 62 mijë e 978. Dhe në arsim kod buxhetor 13620, për furnizim me ushqim dhe pije 15 mijë e 253 euro. Mbeturinat, edhe kjo 13230 11 mijë 657. Te arsimi e pashë.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Ta jap një kjashtësim. Majlinda, mos të habitë këtu kur ti qetë shpenzimet krejt i qetë në përgjithësi çka ka ndodh në komunë. Kur të hynë tash te drejtoritë dhe te kuvendi i qetë specifike të kuvendit, e qetë specifike të shkollës, a këtu te e përgjithshmeja i ke krejt. D.m.th a pe shehë kur të përseritet e kuvendit edhe atje. Edhe te konsulencia këtu të përgjithshmen e ke atë shumë. Tash drejtoritë e bujqësisë i ka hargju ato.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Drejtoreshë këto kode kemi pas edhe më herët praktikë. Shembull, shërbimet këshilldhënëse profesionale, shërbime të veçanta konsulente dhe kontraktore individuale, pajisje tjera, kanë qenë disa kode që janë specifikë edhe zkaonisht ka qenë praktikë e kanë prur para kuvendit, zakonisht kjo për kuvend duhet me pas atë pjesë, se ato janë të ndara dhe secili e ka përshkrimin e vetë. Unë po lidhem dhe një here te kjo tabela, shëbull buxheti i aprovuar u kuptu tash alokimet e buxhetit po i shohim, shpenzimet sa janë shpenzu. Po shihet, buxheti i pa shpenzu tash te këto shpenzimet tu kanë lidhë me buxhetin e aprovum ose të alokum. Nuk prishë punë, shpenzim, ndërsa buxheti i pashpenzum tash kur ti marrsh me shpenzimet e kalon të alokumet, lidhet me buxhetin e aprovuar, ndësa këtu përqindja nuk përputhet me këto nëse i merrë shpenzimet dhe buxheti i pa shpenzum duhet me dalë në bazë të këtyre 2 vlerave dhe kjo është shpenzim dhe kjo pa shpenzu, atëhere diferenca është përqindja. Këtu d.m.th nuk lidhen këto, se kjo është marrë shpenzimi dhe pjesa e alokumet nuk u marrë. Në bazë të kësaj table shihet që është gabim. Më heret e kanë lidhë ose me të alokumet ose të aprovumet. Nëse dikush e shef, shembull shpenzim i ke 2 milion, kanë mbetur 39%, nuk delë.

znj.Majlinda Shabani: Te kodi 13440, shërbimet këshilldhënëse dhe profesionale e ka një diferencë në vit mbi 54 mijë. D.m.th në vitin 2023 ka qenë 11 mijë e 298, tashë është 65 mijë e 427, është një rritje shumë e madhe. Një informacion për këtë me na e sjellë në kuvend.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A jeni që kjo pikë të shkojë në kuvend? Pra, me të gjitha votata pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, kjo pikë shkon në kuvend.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2025

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ju e dini që në takimin e fundit e kemi themeluar komisionin për hartimin e punës së kuvendit komunal për vitin 2025 dhe ne tash pjesën e parë kemi marrë me sekretarin e kuvendit, bazuar në planet e mëhershme që janë të parapara 90% me ligjë i kemi prurë për këtë kuvend në diskutim publik, ndërsa tashti me diskutim publik me komisionin do të diskutojmë. Ne jemi orientu sikur çdo vit që kemi marrë që me qitë në diskutim publik gjatë muajit të diskutimit publik. D.m.th edhe me komisionin e bisedojmë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Plani i punës është e drejtë ekskluzive e kuvendit, por megjithatë edhe ekzekutiva kontribuon. I pash disa lëshime, këto është mirë me i menjanu. E lexova se më ka bërë përshtypje se keni avansu bukur shumë, gjithherë e ka përsëritë për vitin 2024, gjithherë bisedojmë këtu për vitin 2025. Nuk është mirë me na dalë në këtë formë. Vërejtje tjetër nuk kisha. Te përfundimi gjithëherë e ka qitë 2024, a gjithëherë diskutohet për vitin 2025. Këto në t'i përmirëson.

znj.Majlinda Shabani: Edhe diçka që ish kanë mirë me përfshi në kuadër të punës së kuvendit komunal, ka qenë dhe çështja e mbeturinave. E dimë që sado pak të pakten me mujtë me ftu një përfaqësues që është prej "Ekohigjenes" me ardh me raportu në kuvend, me na informu. Tash jemi dhe në sezonin kur kanë ardh mërgimtarët, dhe në shesh kur kam dalë një natë vonë kam parë që ka pas shumë mbeturina dhe është një problem shumë i madhë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Si kërkesë e saj është me vend. Ne jemi tu bë përpjekje dhe na vjen se është kjo i përgjegjshëm ai. Ne kemi pas propozimin e "Ekohigjenes". Nuk e di a e ke përcjellë, të cilën ka propozu 50/50 me i marrë 3 punëtorë. E kemi aprovu mënjëherë. E ka shti edhe kryesuesi informatën. Kur juve ja u merr mendja e thirrë e përgatit informatën. Për të gjitha pyetjet mundeni me ju drejtu. Në rast se pajtohemi, seanca e parë që vjen pas kesaj seance, e njoftoj Haxhien që në ta përgatit informatën.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Unë mendoj që drejtori i "Ekohigjenes" duhet me qenë aty me drejtorin e shërbimeve publike. Informata vjenë prej drejtorit të shërbimeve publike, nuk vjenë prej atij. Ne lypim informata, ai raport nuk na jep, ai nuk është organ i joni. Neve na jep informatë Drejtoria e Shërbimeve Publike, po në kuadër të asaj duhet me ardh edhe përfaqësuesi i "Ekohigjenes" dhe ne duhet me pyet ata me marrë informatë më shumë, por neve na vjen prej Drejtorisë së Shërbimeve Publike se, kjo është përgjegjëse për të dhe ne ja drejtorjm pyetjet atij. A jeni që plani i kuvendit të shkon në kuvend? Me votat e të gjithëve miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e katër e rendit të ditës:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik draft rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoha për vitin 2025

Kryesuesi, z.Bakim Azizi: E dini që në kuadër të bugjetit shkon edhe kjo rregullore e cila miratohet çdo vit, e cila vlenë vetem për një vit kalendarik. Matrialin nuk e kemi, po jam për me dërgu në kuvend. E nëse në kuvend nuk vjen materialin, e hekmi nga rendi i ditës. A jeni që të shkon në kuvend kjo pikë e rendit të ditës. Me votat e të gjithëve shkon në Kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e pestë e rendit të ditës:

5. Informat nga DKA-ja, zhvillimi i procesit edukativo arsimor dhe përfundimi i gjysmëvjetorit të dytë për vitin shkollor 2023-2024

znj.Arta Ajeti, drejtoreshë e DKA-së: Përshendetje të nderuar të pranishëm! Sot para juve e kam sjellë informatën për zhvillimin e procesit edukativo arsimor dhe përfundimi i gjysmëvjetorit të dytë për vitin shkollor 2023-2024. Procesi mësimor ka fillu me kohë, me datën 1 shtator 2023 dhe ka përfunduar 24 qershor 2024. Gjatë këtij viti kalendarik është bërë rekrutimi i personelit arsimor, nuk kemi pas probleme, me përjashtim të Gjuhës Gjermane, kemi bërë zgjedhje. Matrialin e kemi marr me kohë, për pyetjet shpesh jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Illir Zuka: Drejtoreshë, faleminderit për informatën që naj ke sjellë. Flitet që një numër i nxënësve nuk kanë

shprehë dëshirën me hy në test të maturës. Sa është e vërtet kjo?

znj.Arta Ajeti, drejtoreshë e DKA-së: Jo, ne nuk e kemi pas këtë problem, me përjashtim tek shkolla teknike, ku disa nxënës nuk shkojnë në studime, nuk e kanë obligative, se përndryshe të gjithë nxënësit ju kanë nënshtruar testit.

z.Jakup Demiri: Dimrit shkolla “Nijazi Rexhepi” në Sllatinë, për shkak të problemit të objektit po duhet me u transferu nxënësat në shkollën e Sllatinës. Unë po thamë që është mirë që me i testu të gjitha shkollat që kanë qasi probleme. Edhe materiali si material i ka disa të dhëna, po është pak i mangët, sepse nuk ka analizë as të personelit as të disiplines.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Drejtoreshë, a ki informata a lëshohet Gjimnazi këtë vit me 1 shtator?

znj.Arta Ajeti drejtoreshë e DKA-së: Isha në vizitë tek puna që është duke u bërë tek Gjimnazi, i cili financohet nga Bashkim Europian, mirëpo ne nuk i kemi zhvillu procedurat e prokurimit. Dëshira jonë është që të startojmë në shtator, edhe pse dinamika e punës ish shumë e mirë, nuk po e dimë a do ta kemi të gatshëm për në shtator.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Në raport të mungesave të mësimdhënësve dhe të nxënësve dhe në bazë të numrit të mungesave të mësimdhënësve, a ka ndalesa te pagesa për mësimdhënësit për orët që po i humbin?

znj.Arta Ajeti drejtoreshë e DKA-ë: Po, kemi raport, kemi edhe kërkesa nga drejtorat që kanë prurë kërkesa për ndalim të pagës.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Tek konkurset, kontratat që i keni njëvjeçare që janë me afat të caktuar, ato nuk shpallen pas një viti, e mbrenda vitit duhet të shpallen e ne po i shofim që nuk ju shpallet. Unë mendoj që kjo nuk duhet me ndodhë, se është përgjegjësi ligjore që dikujt i takon, është e ran për ty kjo.

znj.Arta Ajeti drejtoreshë e DKA-së: Jemi tu e pritë një rregullore që i sqaron këto procedura të rekrutimit e të zëvendësimit, jemi tu e pritë këtë rregullore e cila pritët me ardh. Jakup, sa i përket shkollës në Sllatinë “Nijazi Rexhepi”, momentin që ingjinerat kanë thanë që aty nuk mund të mbahet mësim, kemi pas takim me prindrit dhe me pajtimin e tyre janë dakordu që nxënësat t’i dërgojmë në shkollën amë gjatë periudhës deri sa të rregullohet shkolla.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A jeni që edhe kjo pikë e rendit të ditë të shkoj për në kuvend? Me votat e të gjithëve kjo pikë e rendit të ditës shkoj për kuvend. Ju faleminderit për kontributin e dhënë. Me kaq shpall të mbyllur këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi



REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISE · OPSTINA VITINA

Praktim: Dredhjetorja Vitina 08-88-2024			
Nr. Udhëzimit Drej. (No.)	Forma/Status	Shënim Përfundim	Vlera Vitebnost
01-	016/01-		1032



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina-Municipality of Vitina



ZYRA E PROKURIMIT

Për: KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

**INFORMATË E PROKURIMEVE DHE KONTRATAVE TË
NËNSHKRUARA PËR GJASHTËMUJORIN 2024**

(JANAR-QERSHOR 2024)

Korrik 2024

Raport ka të përmbledhur aktivitetet e prokurimit të zhvilluara për ofrimin e shërbimeve, zhvillimin e punëve dhe furnizimeve që janë domosdoshmëri për plotësimin e nevojave të komunës, bazuar në kërkesën e njësive shpenzuese dhe për realizimin e shpenzimeve buxhetore, si dhe për plotsimin e kërkesave të njësive buxhetore dhe mbarëvajtje pa pengesa të aktiviteteve të komunës, si dhe për realizimin e investimeve kapitale të planifikuara në interes të komunitetit dhe mirëqenjes qytetare në përgjithësi, keto aktivitete zyra i zhvillon, bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik. Bazuar në këtë, Zyra e prokurimit ka përgaditur këtë Raport për aktivitetet e prokurimit 6 mujor për vitin 2024, në të cilin janë të përfshirë aktivitetet e realizuara të prokurimit dhe aktivitetet tjera të cilat janë në procedurë e sipër, ku përfshihen në këtë gjashtëmujor

Në gjashtë mujorin e vitit 2024, duke u bazuar në kërkesat e njësive shpenzuese zyra ka inicuar 34 aktivitete të prokurimit. Duke i ndarë ato sipas kategorive ose llojit të ndara në punë, shërbime dhe furnizime, kemi këto të dhëna; 11 aktivitete me lëndë prokurimi Shërbime, 12 aktivitete me lëndë prokurimi Punë dhe 10 me lëndë prokurimi Furnizime, si dhe një aktivitet Konkurs projektimi. Nga këto aktivitete, 24 janë përmbyll si aktivitete, tjerat janë në procedurë. Ndërsa lloji i procedurave e udhëhequra janë si vijon: 23 raste është përdorë procedura e hapur, 8 raste procedura e kuotimi i çmimit dhe 1 aktivitate procedurë me Vlera minimale, dhe 2 aktivitete procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë.

Prej këtyre aktiviteteve të zhvilluara: 19 aktivitete të prokurimit, janë përmbyll dhe janë finalizuar me nënshkrimin e kontratave. Ndërsa, 15 aktivitete të prokurimit janë në zhvillim apo procedim të mëtutjeshëm.

Zyra e prokurimit përveq këtyre aktiviteteve ka realizuar edhe pagesa për Operoret Ekonomik që kanë kryera punë, furnizime apo shërbime sipas kontratave që kanë me komunën tonë.

Shuma e përgjithshme e shprehur në vlerën e kontratave të lidhura është 1,726,870.60 €.

Zyra e prokurimit gjatë kësaj periudhe kohore janë lëshuar 723 Urdhërblere për pagesën e OE të kontraktuar, duke udhëhequr lëndet për kompletim dhe janë dërguar në Thesar për pagesë gjegjësishte ekzekutim. Zyra e prokurimit ka kryer edhe 74 rekomandime për vendimet e ndryshme të komisioneve për hapje dhe vlersim dhe komisioneve tjera.

Gjithashtu duhet përcaktuar se Zyra e prokurimit në gjashtë mujorin e parë, ka kryer punë dhe shërbime të ndryshme sipas kërkesave dhe nevojave të të gjithë njësive shpenzuese, duke ofruar këshillime dhe shërbime profesionale, me qëllimin e mbarvajtjes së punëve në komunë dhe respektimin dispozitave ligjore në fuqi.

Menaxher i zyrës së prokurimit

Fadil ABAZI,





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vitisë
Opština Vitina-Municipality of Vitina



RAPORTI VJETOR PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE

n. rend. 87.2.9.12 të Ligjit Nr. 04/1042, Ligji për Prokurimin Publik në

Data e përgatitjes së raportit:	09.01.2024
---------------------------------	------------

Viti fiskal	2024
-------------	------



PJESA I. IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES

Emri zyrtar i Autoritetit Kontraktues	KOMUNA E VITISË	
Emri i Autoritetit Kontraktues (zgjidhëne njëeren)	KOMUNA E VITISË	
Kodi buxhetor	Vi657	
Adresa	Viti, rruga "28 Nëntori"	
Kodi postar - Qyteti	61000 Viti	
Tel. fiks/ Celulari /Faksi	0280/381 519	044 505 984
Emri i menaxherit të prokurimit	Fadil ABAZI	
E-mail adresa	fadil.n.abazi@rks-gov.net	
Adresa e webit të AK	kk.rks-gov.net/viti/	

PJESA II. KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE

Numri rendor i prokurimit	Nr. i Prokurimit					Titulli i aktivitetit të prokurimit	Data e nënskruarjes së kontratës	Vlera e përshkruar e kontratës (zetimit)	Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat e tj.	Çmimi i Aneks kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat e tj.	Emri i OE të cilit i është dhënë kontrata	Selia e OE të cilit i është dhënë kontrata	OE vendor (1); Jo vendor (2)	Afat kohor normal (1)	Afat kohor i shkurrtuar (2)	Çmimi me i ulët (1)
	Numri prokurimit në sistem	Lloji i prokurimit	Vlera e prokurimit	Procedura e prokurimit	Klasifikimi (2 shifra të para të PPP)											
001	067	2	2	1	93	Blerja e shërbimeve të konsulences individuale për nevojat e projektit Cross border. LOT I,	09.02.2024	42,000.00	28,800.00		MEDIANA BISLIMI					
001	067	2	2	1	93	Blerja e shërbimeve të konsulences individuale për nevojat e projektit Cross border. LOT II,	03.08.2024	14,000.00	12,000.00		ARIAN HAJDARI					
001	067	2	2	1	93	Blerja e shërbimeve të konsulences individuale për nevojat e projektit Cross border. LOT III,	09.02.2024	14,000.00	120,000.00		BESIM IMERI					
002	1071	1	2	1	30	Furnizim me kompjutera dhe pajisje të TI		95,000.00								
003	1078	2	1	1	93	Përmirësimi i shërbimeve në Sektorin e Arsimit, Shëndetësisë dhe Administratës Publike.	17.04.2024	150,000.00	150,000.00		INFINIT LIGHTING					
004	1121	2	2	1	93	Shërbimet e sigurimit të objekteve shkollorë, QKMF dhe Insitucioneve komunale		97,000.00			ANULUAR					

005	1137	2	2	1	93	Shërbimet e ndërcimit profesional, binës, aksesoreve dhe zërrimit për nevoja e Autoritetit kontraktues	22.03.2024	11,500.00	11,212.36	NSHT KORABI			
006	1193	1	3	6	28	Furnizimi montimi i ndërcimit me Lod Par RGP multi kolor, me qëndrim statik për Sallën e koncerteve të Shtëpisë së Kulturës	14.03.2024	2,584.20	1,350.00	SMART MODEL LLC			
007	1317	1	3	6	28	Furnizimi dhe montimi i xhamit (veshur me plumb) për nevojat e Rentegenit në QKMF në Viti.	20.03.2024	2,350.00	2,090.00	ENGINEERING RK SHPK			
008	1509	5	2	1	45	Ndërtimi i ujësjellësve: LOT I: Ndërtimi i ujësjellësit në Radivojc.	13.05.2024	320,000.00	313,438.46	KUSHTRIMI NM			
008	1509	5	2	1	45	Ndërtimi i ujësjellësve: c. LOT II: Ndërtimi i ujësjellësit në Devajë dhe një Segment në Zhiti.	13.05.2024	120,000.00	120,000.00	VIANTE KONSTRUCTI ON HAJRUSHI SHPK			
009	1546	5	1	1	45	Ndërtimi i trotuarëve dhe ndërcimit publik në Komunën e Vitisë.		1,180,000.00					
010		1	3	6	11	Furnizim me oksigjen medicinal- dy vjeçar	27.05.2024	6,000.00	2,932.60	MESSER MEDICA LLC			
011		2	3	3	72	Shërbimet e servisimit dhe mirëmbajtja e aparateve të stomatologjisë	07.05.2024	5000.00	4995.75	PRO MEDICAL			
012		5	2	1	45	Ndërtimi i palestrës sportive shkollore (Sh.f Sllatinë e Epërme)	02.05.2024	480,000.00	468,902.71	EURO COMMERCE			
013		5	1	1	45	Asfaltimi i rrugës së Vërnakollës		1,500,000.00					
014	4713	5	2	1	45	Riparimi i shkollave (Rregullimi i aneksit të SH.M.U Ahmet Hajdari paralelja në Ramnishtë)	27.05.2024	110,000.00	109,859.77	REI COMPANY			
015	2300	1	1	1	29	Furnizimi me mjete për fermer-lavërtari (Spërkatëse 400, Pllugj dhe Makina për mbjelljen e grurit), me mjete bujqësore porim-kulturë (Motokultivator,- Freza, Kosa – dhe Makina për Mbjelejen e qepukajve, mbjellëse misri)	07.05.2024	243,000.00	243,000.00	NPT HALITJAHA SHPK			
016		1	2	1	24	Furnizimi me material higjienik për të gjitha njësit shpenzuese	14.05.2024	34,500.00	25,774.00	OLTI KENZA			
017		1	1	1	25	Furnizimi me sorra 50 m2		150,000.00					
018		1	2	1		Furnizim me reagonsa për QKMFn	21.05.2024	71,241.00	69,993.47	BIOLAB SHPK			
019		1	3	6		Furnizimi me dokumente blanko për nevojat e QKMFs	14.05.2024	6,900.00	4,475.32	BLEDI OP			
						Siç dëshmohet nga...				EUROSI			

021		1	3	6	30	Furnizimi me Swicha	14.05.2024	3,000.00	2,080.00	FATI SEKURITI SHPK			
022	3931	4	1	3	73	Punimi i Hartës Zonale Komunale		150,000.00					
023						Asfaltimi i rrugëve rurale në komunën e Vitisë		2,383,390.00					
024		5	1	1	45	Ndërtimi i urave (Budrikë dhe Skifteraj)		120,000.00					
025	4839	5	2	1	45	Asfaltimi i rrugës së Xhepës - Lubishtë		300,000.00					
026	4987	2	2	1	60	Shërbimet e transportit me autobus për nevojat e Autoritetit kontraktues	02.07.2024	15,000.00	15,000.00	VITIA TRANS			
027		1	3	6	30	Furnizimi me aparat digjital profesional		3,700.00					
028		2	1	1	74	Hartimi i projekteve investive (kapitalo) per komunene e Vitisë		300,000.00					
029	5502	5	2	5	45	Asfaltimi i rrugëve LOT V, Asfaltimi i rrugës Lagja Lulleci-lagja Rexhepi-Ramjan-Anoks	21.08.2024	11,460.00	11,480.00	COMPANY ZUKA COMMERCE			
030	5585	5	2	1	45	Rënovimi i ambulanteve në Viti		110,000.00					
031	5858	2	1	1	93	Mirëmbajtja verore dhe dimrore e rrugëve në territorin e komunës së Vitisë-dy vjeçar		200,000.00					
032		2	1	1	93	Shërbimet e mirëmbajtjes së sistemit të makinorive komunale dhe të tjera-dy vjeçar		140,000.00					
033		5	2	1	45	Ndërtimi i rrugës me zhavor Stubbëll - Stançiq		438,373.00					
034		1	3	6		Blerja e instrumente muzikore për shkollën e muzikës,		9,000.00					
								8,849,068.20	1,726,870.60				

